



REPUBLIKA E KOSOVËS	REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE	OSNOVNI SUD
G.J.A-Su.A	19 / 2023
Dt:	20.01.2023
GJILAN - GNJILANE	

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

20 janar 2023

## Raporti i rregullt i punës

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Tetor – Dhjetor 2022

Bazuar në nenin 14, pika 2 nën pika 2.5 të Ligjit për Gjykatat dhe pika 5 e nenit 11 të Rregullores Nr. 02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan paraqet raportin e rregullt të punës.

Raporti i rregullt i punës së Gjykatës Themelore në Gjilan përfshinë periudhën raportuese nga 1 tetor deri më 31 dhjetor 2022.

## I. Hyrje

Raporti i Gjykatës Themelore të Gjilanit paraqet të gjitha të dhënat statistikore për këtë periudhë, të arriturat, sfidat, por edhe pengesat që kanë qenë gjatë kësaj periudhe.

Ky raport është i bazuar në detyrat dhe objektivat e projektuara dhe të përcaktuara paraprakisht me Planin Vjetor të Punës, Planet Periodike dhe Planin Strategjik Operativ të Gjykatës.

## II. Struktura e Gjykatës Themelore në Gjilan me Degët e saja

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit së bashku me Degët, Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, janë gjithsejtë 35 gjiqtarë (përfshirë edhe kryetarin e gjykatës), të caktuar në departamente dhe divizione.

Gjykata Themelore në Gjilan – Selia, aktualisht ka 23 gjiqtarë (përfshirë edhe kryetarin e gjykatës).

Në Departamentin e Krimeve të Rënda aktualisht janë 6 gjiqtarë, në Departamentin për të Mitur punon 1 gjiqtar, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal punojnë 6 gjiqtarë, në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil punojnë 8 gjiqtarë dhe në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Kundërvajtjes punon 1 gjiqtar.

**Dega e Gjykatës Themelore në Kamenicë:** Kjo degë aktualisht ka 4 gjyqtarë, prej tyre 2 gjyqtarë në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal të cilët i kryejnë edhe lëndët kundërvajtëse dhe 2 gjyqtarë në Divisionin Civil.

**Dega e Gjykatës Themelore në Viti:** Në këtë degë kemi aktualisht kemi 6 gjyqtarë, prej tyre 3 gjyqtarë në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, 3 gjyqtarë në Divisionin Civil. Gjyqtari mbikëqyrës i kësaj dege kryen procedurën paraprake dhe është i ngarkuar me 50 % të lëndëve civile, së bashku me gjyqtarët lëmisë civile. Ndërsa lëndët kundërvajtëse i kryejnë gjyqtarët të lëmisë penale.

**Dega e Gjykatës Themelore në Novobërdë:** Në këtë degë kemi dy gjyqtarët të cilët gjykojnë lëndë civile, ndërsa lëndë penale i gjykon gjyqtari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi.

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit, lëndët ndahen me Sistemin e Programit SMIL, ashtu siç është caktuar me Rregulloren mbi veprimtarinë e gjykatave.

### **III. Raportet statistikore**

Të dhënat statistikore i kemi të paraqitur në formë tabelare të cilat janë të nxjerra nga Programi SMIL.

Gjykata Themelore Gjilan	Lëmia	Lëndët e trashëgura	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u>
		I	II	III	IV	V	II - IV
Dep. Krimeve të Rënda	Paraprake	228	<u>59</u>	287	<u>37</u>	250	<u>63 %</u>
	Penale	427	<u>129</u>	556	<u>70</u>	486	<u>54 %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	461	<u>64</u>	525	<u>54</u>	471	<u>84 %</u>
	Penale	1883	<u>386</u>	2269	<u>390</u>	1879	<u>101 %</u>
	Civile	4361	<u>509</u>	4870	<u>505</u>	4364	<u>99 %</u>
	Jashtëkontestimore	116	<u>71</u>	187	<u>62</u>	125	<u>87 %</u>
	Përmbarimore	419	<u>236</u>	655	<u>261</u>	394	<u>111 %</u>
Dep. për të Mitur	Përgatitore për të mitur	27	<u>8</u>	35	<u>6</u>	29	<u>79 %</u>
	Penale para kolegjit	108	<u>40</u>	148	<u>31</u>	117	<u>78 %</u>
Divizioni Kundërvajtjes	Kundërvajtje	1750	<u>426</u>	2176	<u>350</u>	1826	<u>82 %</u>
	<b>TOTALI</b>	<b>9780</b>	<b><u>1928</u></b>	<b>11708</b>	<b><u>1766</u></b>	<b>9941</b>	<b><u>91 %</u></b>

Dega e Themelores Kamenicë	Lëmia	Lëndët e trashëgura	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përgindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> <u>II – IV %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	76	<u>9</u>	85	<u>10</u>	75	<u>111 %</u>
	Penale	397	<u>82</u>	479	<u>66</u>	413	<u>80 %</u>
	Civile	1139	<u>90</u>	1229	<u>137</u>	1092	<u>152 %</u>
	Jashtëkontestimore	44	<u>7</u>	51	<u>2</u>	49	<u>29 %</u>
	Përmbarimore	140	<u>83</u>	223	<u>96</u>	127	<u>116 %</u>
	Kundërvajtje	259	<u>218</u>	477	<u>113</u>	364	<u>52 %</u>
<b>TOTALI</b>		<b>2055</b>	<b><u>489</u></b>	<b>2544</b>	<b><u>424</u></b>	<b>2120</b>	<b><u>86 %</u></b>

Dega e Themelores Viti	Lëmia	Lëndët e trashëgura	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përgindja e lëndëve të ardhur dhe të zjidhura</u> <u>II - IV %</u>
	Paraprake	37	<u>20</u>	57	<u>18</u>	39	<u>90 %</u>
	Penale	1481	<u>199</u>	1680	<u>197</u>	1483	<u>99 %</u>
Dep. Përgjithshëm							
Civile	3380	<u>270</u>	3650	<u>166</u>	3484	<u>61 %</u>	
Jashtëkontestimore	51	<u>9</u>	60	<u>9</u>	51	<u>100 %</u>	
Përmbarimore	599	<u>79</u>	678	<u>154</u>	524	<u>195 %</u>	
Kundërvajtje	705	<u>175</u>	880	<u>135</u>	745	<u>77 %</u>	
TOTALI		<u>6253</u>	<u>752</u>	<u>7005</u>	<u>679</u>	<u>6329</u>	<u>90 %</u>

Dega e Themelores Novobërdë	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përgindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> <u>II - IV %</u>
	Paraprake	12	<u>0</u>	12	<u>0</u>	12	<u>0 %</u>
	Penale	205	<u>18</u>	223	<u>48</u>	175	<u>267 %</u>
Dep. Përgjithshëm	Civile	404	<u>48</u>	452	<u>91</u>	361	<u>190 %</u>
	Jashtëkontestimore	186	<u>14</u>	200	<u>25</u>	175	<u>179 %</u>
	Përmbarimore	42	<u>18</u>	60	<u>17</u>	43	<u>94 %</u>
Divizioni Kundërvajtjes	Kundërvajtje	131	<u>82</u>	213	<u>60</u>	153	<u>73 %</u>
<b>TOTALI</b>		<b>980</b>	<b><u>180</u></b>	<b>1160</b>	<b><u>241</u></b>	<b>919</b>	<b><u>133 %</u></b>

## Statistikat e përgjithshme

### Gjkata Themelore Gjilan së bashku me Degët

	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbeturë	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura %</u>
Totali	19068	3349	22417	3110	19309	92 %

#### IV. Përbushja e objektivave

a) **Zvogëlimi i ngarkesës së lëndëve për gjyqtarë dhe ndarja e tyre:** në tremujorin e katërt të këtij viti kemi tentuar që të inkurajojmë sa ma tepër gjyqtarët që të njëjtit të caktojnë dhe përfundojnë lëndët sa më shumë që është e mundur si në Divisionin Penal dhe atë Civil dhe mund të konsiderojmë se është punuar, por ka hapësirë edhe më tepër të punohet. Si sfidë e kësaj gjykate në këtë tre mujor ka qenë në Divisionin Civil, ku ka pas lëndë të kthyera në rigjykim qysh para dy vite e më tepër dhe nuk janë caktuar nga gjyqtarët të këtij divizioni, por tani mund të themi se janë futur në punë pothuajse të gjitha lëndët e rigjykimit, gjithashtu nga të njëjtit gjyqtarët është kërkuar të i trajtojnë çështjet sipas prioriteteve të cilat i jep ligji dhe sipas rendit të ardhjes së gjykatë të lëndëve, e jo të i zgjedhin lëndët e natyrës së më të lehtë.

Nga gjyqtarët e Divisionit Penal (DKR, DP dhe DM) është kërkuar që të caktojnë sa më tepër lëndë që është e mundur.

Gjithashtu nga gjithë gjyqtarët të kësaj gjykate është kërkuar që të rrisin efikasitetin, duke angazhuar bashkëpunëtorët profesional, pasi që në Divisionin Civil, secili gjyqtar ka të caktuar një bashkëpunëtor, kurse në Divisionin Penal momentalisht janë të ndarë një bashkëpunëtor punon për 2 gjyqtarë.

b) *Sa i përket DKR*, në këtë gjykatë i është dhënë prioritet lëndëve të natyrës së korruptionit dhe nuk është asnje lëndë që nuk është në punë.

c) *Rritja e transparencës së gjykatës*: ishte si objektivë e gjykatës sonë që gjatë kësaj periudhe të kontribuojmë edhe më tepër në rritje të transparencës me qytetarët, institucionet dhe me shoqërinë civile. Kemi pranuar disa kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, pyetje të gazetarëve dhe ju kemi përgjigjur brenda afatit kérkesave, gjithashtu kemi takuar qytetarë, avokatë përfaqësues të OJQ-ve.

Gjithashtu kemi bërë përpjekje për të publikuar sa më tepër vendime gjyqësore ku sipas monitorimit të Lëvizjes FOL, kemi dal si e para në nivel të gjykatave themelore.

#### V. Identifikimi i problemeve me të cilat është ballafaquar gjykata

Disa nga sfidat të cilat janë paraqitur gjatë muajve tetor – dhjetor të vitit 2022, janë të ngjashme me tremujorshit paraprak edhe atë si më poshtë:

a) Është mungesa e përkthyesve gjuhësor, që kjo për në si Gjykatë po paraqet mjaft problem. Ky problem si në qendër edhe në degë është i përhershëm (Dega në Kamenicë nuk ka asnje përkthyes, por një përkohësisht e kemi dërguar nga qendra), pasi që kem mungesë të 3 deri 4 përkthyes gjyqësor të gjuhës shqipe – serbe, e gjithashtu si sfidë mbetet edhe stafi administrativ (zyrtarët ligjore – sekretaret juridike dhe referentët) disa prej

tyre janë në moshë të shtyrë dhe kanë probleme me shëndetin, me përdorimin e teknologjisë dhe përdorimin e sistemit SMIL e gjithashtu kem mungesë edhe të zyrtarit për statistika, pasi që zyrtari i cili ka qenë në këtë funksion është pensionuar dhe mungesë të zyrtareve ligjore, ku aktualisht pa zyrtare ligjore i kem 3 gjyqtarë.

- b) Sa i përket stafit administrativ që janë punësuar kemi pasur probleme edhe këtë tremujor (por gjendja ka filluar të përmirësohet në raport me kohën e mëparshme), për shkak se një pjesë e tyre nuk ka respektuar vendin, orarin dhe detyrat e punës në vazhdimësi dhe si pasojë kemi pasur vonesa në procedimin e lëndëve dhe parashtresave të ndryshme tek gjyqtarët, procedimin e ankesave në instanca më të larta, pastërtia nuk ka qenë në nivel, kemi pasur vonesa në Zyrën e Financave etj. etj. dhe për këto lëshime nuk është marrur administratorja si person përgjegjës i administratës apo ndonjë udhëheqës i drejtpërdrejt i tyre edhe përkundër faktit se shumë herë kam kërkuar nga e njëjtë që të merret me këto probleme, por fatkeqësisht nuk është ndërmarr asnë veprim në drejtim të përmirësimit të kësaj problematike, por unë si krytar është dashtë të merrem me këto çështje.
- c) Për Gjykatën Themelore në Gjilan së bashku me degët si problem është edhe numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve, sidomos në Degën e Vitisë.
- d) Një sfidë tjetër për lëndët penale është mungesa e prokurorëve si në qendër ashtu edhe në Degët Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, ku ka mungesë të theksuar të prokurorëve dhe për këtë çështje kemi biseduar edhe me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ku i njëjti na ka njoftuar se pa u bërë plotësimi i vendeve të lira në këtë prokurori nuk mund të përmirësohet gjendja;
- e) Sa i përket Sistemit SMIL, ne më lartë i kemi paraqitur statistikat, por të njëjtat nuk janë të sakta sa i përket ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatës në përgjithësi dhe në vazhdimësi me zyrtarët e SMIL-it dhe personat përgjegjës të SKGJK-së kemi bërë përpjekje të eliminojë këto gabime në raporte statistikore dhe gabime të tjera, por deri në këtë momente nuk kemi arritur dhe padyshim që paraqitet si problematik në punën ditore të gjykatës;

f) Sa i përket teknologjisë kem mungesë të printerëve funksional, nëpër zyre të stafit (gjyqësore dhe administrativ), gjithashtu ka probleme të vazhdueshme edhe nëpër salla të gjykimeve;

## **VI. Propozimi i hapave riparues**

Kryetari i Gjykatës kërkon nga KGJK dhe SKGJK-ja që të rekrutoj gjyqtarë për këtë Gjykatë dhe degët e saj, të shpall konkurs për përkthyes nga gjuha shqipe në serbe dhe anasjelltas; për zyrtarë ligor dhe për zyrtar të statistikave, të organizoj trajnime për stafin administrativ dhe të ketë vizita më të shpeshta në Gjykatë nga komisionet përkatëse.

## **VII. Të arriturat**

Në tremujorin e katërt në secilin departament – divizion mund të konsiderojmë se ka pasur lëvizje pozitive dhe përpjekje maksimale që të përfundohen sa më tepër lëndë në raport me tremujorin paraprak, ka pas rezultate në respektimin e orarit, vendit dhe detyrat e punës nga të gjithë të punësuarit në këtë Gjykatë.

## **VIII. Përfundimi**

Në bazë të dhënave statistikore nuk mund të jemi i kënaqur, por siç thash më lartë në vazhdimësi bëjmë përpjekje, kërkojmë, bisedojmë që stafi administrativ të jetë më efektiv, kurse sa i përket gjyqtarëve nga të njëjtit në vazhdimësi kam kërkuar që të caktojnë – procedojnë lëndë sa më tepër që është e mundur, të caktojnë lëndët e rigjykimit dhe të trajtojnë çështjes sipas arritjes në gjykatë dhe konsiderojë që në muajt në vazhdim do të ketë edhe më tepër rezultate për përfundimin e lëndëve.

Sa i përket, transparencës, llogaridhënie, objektivitetit, paanshmërisë dhe pavarësisë, unë në vazhdimësi kërkojë nga gjyqtarët dhe të njëjtit i inkurajoj që të jenë të pavarur dhe të paanshëm në trajtimin e çështjeve, pasi që

kthimi i besimit në Gjykatën Themelore në Gjilan është objktivi ynë kryesor dhe kjo mund të arrihet me punë dhe angazhim maksimal nga gjithë punonjësit e kësaj gjykate.

**Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Venhar Salihu**

**Data: 20.01.2023**

